Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula _____



Shtojca 8

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- c. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- b. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Dokumentat Standarde të Tenderit

License sipas objektit të prokurimit, ose e pasqyruar në QKR.

Xhiroja vjetore gjatë tre viteve të fundit (2015-2016-2017), me një vlerë sa 40% e fondit limit që prokurohet.

Një çertifikatë të gjendjes financiare (me vlerë sa 10 % e fondit limit që prokurohet) nga një ose më shumë banka, jo më parë se 10 (dite) ditë nga data e zhvillimit të tenderit.

Informacione të mëtejshme në dokumentat e tenderit

III.1.3 Kapaciteti teknik:

Informacione dhe formalitete të nevojshme për të vlerësuar nëse janë përmbushur kërkesat:

1.3.a. Kontratë të ngjashme të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2015-2016-2017), ku vlera e realizuar të jetë sa 40 % e vlerës që prokurohet.

a) Kërket që ofertuesi të paraqesë kontrata të ngjashme dhe vertetime për realizimin me sukses të tyre, ose fatura tatimore shitje.

b) Të ketë të punësuar jo më pak se 5 (pese) persona, e provuar kjo me vertetim për pagimin e sigurimeve shoqërore.

c) Grafiku i levrimit do të përcaktohet në kontratë sipas kërkesave të institucionit. ■

Subjekti ekonomik i interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë tenderimi të paraqitet pranë autoritetit kontraktor Drejtoria e Shërbimit spitalor Korce, deri në momentin e zhvillimit të procedurës për të marrë mostrat për çdo artikull dhe për tu njohur me specifikimet teknike përkatëse për çdo artikull.

(Autoriteti kontraktor nuk do të marrë parasysh ofertat e dhëna nga ofertuesit të cilët nuk janë njohur paraprakisht me përpara me mostrat).

Public Health Sector

Informacione të mëtejshme në dokumentat e tenderit

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Dokumentat Standarde të Tenderit

Nr	EMERTIMI	Njesia	Formati	Nr.i fleteve/cope
1	2	3	4	5
1	Kartelet klinike(kater flete dekursi me fletet e kostos)	copë	A4	14
2	Kartelet infermiore Pediatrike	copë	A4	6
3	Kartelet infermiore Semundjeve te Brendshme	copë	A4	6
4	Kartelet ditore	copë	A4	6
5	Kartelet klinike Obstetrike-Patologjike	copë	A4	9
6	Kartelet klinike gjinekologjike(me 4 flete dekursi)	copë	A4	6
7	Kartelet infermiore Obstetrike-Gjinekologji	copë	A4	6
8	Kartelet personale ambulatorore	copë	A4	2
9	Kartelet e dhuruesit te gjakutper here te pare (karton)	copë	210x150	1
10	Kartelet e te porsalindurit	copë	A4	4
11	Kartelet infermiore e Neonatit	copë	A4	3
12	Kartelet per ndjekjen e femijes 0-6 vjec	copë	A4	24
13	Bllok Dorezim teshash me karbon(me 30 flete)	copë	155 x 110	30 x 2
14	Bllok Mandat Arketimi (me 30 flete)	copë	195 x 150	30 x 3
15	Bllok Urdher Dorezimi	copë	155 x 125	50 x 2
16	Bllok terheqje barnash me karbon (1+2 kopje)(30 flete)	copë	195 x 150	30 x 3
17	Bllok flete hyrje me karbon	copë	210x150	30x3
18	Bllok flete kerkese gjaku	copë	210x150	30x3
19	Regjister Indeksi per personelin (me 100 flete)	copë	335 x 250	100
20	Liber Page(100 flete)	copë	300 x 270	100
21	Regj. Pagese Roje-Thirrje- Operacion	copë	A4	100
22	Regjister magazine(200 flete)	copë	A4	200
23	Regjister Denoncimi(200 flete)	copë	A4	200
24	Regjister Statistike(250 flete)	copë	A4	250
25	Regjister Statistike i Semundshmerise(flete 250)	copë	420 x 300	250
26	Regjister Alfabetik per statistiken(200 flete)	copë	330 x 235	200
27	Regjister pa koke(100 flete)	copë	430 x 300	100
28	Model regjistri Nr.1(Sherbimi Ambulator)150 flete	copë	330 x 300	150
29	Model regjistri Nr.2 Receptionsi (Sherbimi i Urgjences)150 flete	copë	600 x 420	150
30	Model regjistri Nr.3(Sherbimet me shtreter)150 flete	copë	330 x 300	150
31	Model regjistri Nr.4(Sherbimi i Laboratorit dhe Imazherise)150 flete	copë	330 x 300	150
32	Model regjistri Nr.6(Shkarkimi i barnave per Pranim-Urgjencen)150 flete	copë	A 4	150
33	Regjister per shkarkimin e barnave ne pavion(250 flete)	copë	A 4	250

Dokumentat Standarde të Tenderit

34	Regjister i thirrjes se mjekut specialist(150 flete)	copë	A 4	150
35	Regjister dorezim turni	copë	A4	100
36	Regjister shperndarje gjaku per banke gjaku	copë	A4	100
37	Regjister per mbledhje gjaku	copë	A4	100
38	Regjister shperndarje komponente per banka gjaku	copë	A4	100
39	Regjister I perdorimit te gjakut dhe produkteve te tij ne klinike	copë	A4	100
40	Regjistri i referimit te te semureve per Tirane, Elbasan etj	copë	A4	100
41	Regjister themeltar i Salles se Operacionit	copë	A4	200
42	Regjister themeltar i Salles se Operacionit	copë		100
43	Regjister protokolli(korrespondence)	copë		200
44	Regjister indeksi statistike	copë		200
45	Libri I Arkes(me karbon) 3 flete	copë		30x3
46	Flete analize gjaku(per sherbimin e urgjences)	copë	A 4	1
47	Flete analize urine(sherbimin e urgjences)	copë	A 4	1
48	Qendra kombetare e tranfuzionit te gjakut(Agjentet Infektive)	copë	A 4	1
49	Qendra kombetare e tranfuzionit te gjakut(Imunoserologjise)	copë	A 5	1
50	Flete audiograme	copë	A 4	1
51	Flete Urdher sherbimi	copë	A 4	1
52	Formulari i vleresimit te performances se personelit	copë	A 4	3
53	Flete-kerkese per sherbimin e transfuzionit te gjakut	copë	A 4	1
54	Flete udhetime Nr.1	copë	A 4	1
55	Flete udhetime Nr.2	copë	A 4	2
56	Flete udhetime Nr.3	copë	A 4	1
57	Flete raporti Mjeko-Ligjor me ngjyre	copë	210 x 145	1
58	Certifikate Asistence ne Lindje	copë	A 4	1
59	Flete analize Urina komplet	copë	150 x 145	1
60	Flete analize Gjak komplet	copë	145 x 95	1
61	Flete pune per reanimacion (Neonatologji)	copë	A 4	1
62	Pyetsor mbi kenaqesine e personelit shendetesor ne pune	copë	A 4	1
63	Flete force	copë	195 x 85	1
64	Flete echo-gjinekologjike	copë	A 4	1
65	Flete echo-obstetrike	copë	A 4	1
66	Flete dalje nga spitali	copë	A 4	1
67	Flete percjellese per ekzaminime histo-patologjike	copë	A 4	1
68	Rekomandim i brendshem	copë	A 4	1
69	Flete drejtimi per kemp	copë	A 4	1

Dokumentat Standarde të Tenderit

70	Flete recete e thjeshte(blok me 100 flete)	copë	140 x 95	1
71	Flete kosto e shpenzimeve	copë	A 4	1
72	Flete analize biokimike	copë	210x150	1
73	Flete percjellese per invalidet	copë	250x175	1
74	Flete shtojce karteles	copë	A4	2
75	Flete autorizimi	copë	210x250	1
76	Flete Echo Abdominale	copë	A4	1
77	Flete raportimi ditor	copë	A4	1
78	Efekte te padeshiruara te dhurimit	copë	A4	1
79	Rezultatet e laboratorit te sherbimit te transfuzionit	copë	A4	1
80	Pyetesor per dhuruesit e gjakut	copë	A4	2
81	Aprovimi i pacientit per transfuzionin e gjakut	copë	A4	1
82	Instrumentat e monitorimit	copë	A4	1
83	Regjister I planifikimit te edukimit ne vazhdim	copë	A4	100
84	Flete vezhgimi i semundjes(Kirurgji)	copë	A4	1
85	Regjister i planit te prodhimit	copë	A4	100
86	Regjister i shperndarjes se ushqimit	copë	A4	100
87	Regjister mjekimi Kardiologji	copë	A4	200
88	Pyetesor per pacientin	copë	A4	3
89	Flete ditore ushqimi Spital	copë	A4	
90	Flete ditore ushqimi Maternitet	copë	A4	
91	Certifikate Edukimi(me ngjyre)	copë	A4	

Public Health Sector

Dokumentat Standarde të Tenderit

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	EMERTIMI	Njesia	Formati	Nr.i fleteve/cope	Sasia
1	2	3	4	5	6
1	Kartelet klinike(kater flete dekursi me fletet e kostos)	copë	A4	14	10000
2	Kartelet infermiere Pediatrike	copë	A4	6	2000
3	Kartelet infermiere Semundjeve te Brendshme	copë	A4	6	8000
4	Kartelet ditore	copë	A4	6	15000
5	Kartelet klinike Obstetrike-Patologjike	copë	A4	9	2000
6	Kartelet klinike gjinekologjike(me 4 flete dekursi)	copë	A4	6	100
7	Kartelet infermiere Obstetrike-Gjinekologji	copë	A4	6	2000
8	Kartelet personale ambulatorore	copë	A4	2	1000
9	Kartelet e dhuruesit te gjakutper here te pare (karton)	copë	210x150	1	300
10	Kartelet e te porsalindurit	copë	A4	4	500
11	Kartelet infermiere e Neonatit	copë	A4	3	300
12	Kartelet per ndjekjen e femijes 0-6 vjec	copë	A4	24	1500
13	Bllok Dorezim teshash me karbon(me 30 flete)	copë	155 x 110	30 x 2	100
14	Bllok Mandat Arketimi (me 30 flete)	copë	195 x 150	30 x 3	1500
15	Bllok Urdher Dorezimi	copë	155 x 125	50 x 2	300
16	Bllok terheqje barnash me karbon (1+2 kopje)(30 flete)	copë	195 x 150	30 x 3	500
17	Bllok flete hyrje me karbon	copë	210x150	30x3	50
18	Bllok flete kerkese gjaku	copë	210x150	30x3	100
19	Regjister Indeksi per personelin (me 100 flete)	copë	335 x 250	100	2
20	Liber Page(100 flete)	copë	300 x 270	100	14
21	Regj. Page se Roje-Thirrje- Operacion	copë	A4	100	1
22	Regjister magazine(200 flete)	copë	A4	200	10
23	Regjister Denoncimi(200 flete)	copë	A4	200	3
24	Regjister Statistike(250 flete)	copë	A4	250	5
25	Regjister Statistike i Semundshmerise(flete 250)	copë	420 x 300	250	10
26	Regjister Alfabetik per statistiken(200 flete)	copë	330 x 235	200	8
27	Regjister pa koke(100 flete)	copë	430 x 300	100	20
28	Model regjistri Nr.1(Sherbimi Ambulator)150 flete	copë	330 x 300	150	50
29	Model regjistri Nr.2 Receptionsi (Sherbimi i	copë	600 x 420	150	20

Dokumentat Standarde të Tenderit

	Urgjences)150 flete				
30	Model regjistri Nr.3(Sherbimet me shtreter)150 flete	copë	330 x 300	150	10
31	Model regjistri Nr.4(Sherbimi i Laboratorit dhe Imazherise)150 flete	copë	330 x 300	150	20
32	Model regjistri Nr.6(Shkarkimi i barnave per Pranim-Urgjencen)150 flete	copë	A 4	150	10
33	Regjister per shkarkimin e barnave ne pavion(250 flete)	copë	A 4	250	15
34	Regjister i thirrjes se mjekut specialist(150 flete)	copë	A 4	150	20
35	Regjister dorezim turni	copë	A4	100	150
36	Regjister shperndarje gjaku per banke gjaku	copë	A4	100	2
37	Regjister per mbledhje gjaku	copë	A4	100	2
38	Regjister shperndarje komponente per banka gjaku	copë	A4	100	2
39	Regjister I perdorimit te gjakut dhe produkteve te tij ne klinike	copë	A4	100	5
40	Regjistri i referimit te te semureve per Tirane, Elbasan etj	copë	A4	100	2
41	Regjister themeltar i Salles se Operacionit	copë	A4	200	1
42	Regjister themeltar i Salles se Operacionit	copë		100	1
43	Regjister protokolli(korrespondence)	copë		200	1
44	Regjister indeksi statistike	copë		200	1
45	Libri I Arkes(me karbon) 3 flete	copë		30x3	50
46	Flete analize gjaku(per sherbimin e urgjences)	copë	A 4	1	10000
47	Flete analize urine(sherbimin e urgjences)	copë	A 4	1	5000
48	Qendra kombetare e tranfuzionit te gjakut(Agjentet Infektive)	copë	A 4	1	200
49	Qendra kombetare e tranfuzionit te gjakut(Imunoserologjise)	copë	A 5	1	500
50	Flete audiograme	copë	A 4	1	1000
51	Flete Urdher sherbimi	copë	A 4	1	1200
52	Formulari i vleresimit te performances se personelit	copë	A 4	3	500
53	Flete-kerkese per sherbimin e transfuzionit te gjakut	copë	A 4	1	200
54	Flete udhëtimi Nr.1	copë	A 4	1	1000
55	Flete udhëtimi Nr.2	copë	A 4	2	1500
56	Flete udhëtimi Nr.3	copë	A 4	1	1000
57	Flete raporti Mjeko-Ligjor me ngjyre	copë	210 x 145	1	5000
58	Certifikate Asistence ne Lindje	copë	A 4	1	1500
59	Flete analize Urina komplet	copë	150 x 145	1	15000
60	Flete analize Gjak komplet	copë	145 x 95	1	15000
61	Flete pune per reanimacion (Neonatologji)	copë	A 4	1	100
62	Pyetsor mbi kenaqesine e personelit shendetesor ne pune	copë	A 4	1	1000

Dokumentat Standarde të Tenderit

63	Flete force	copë	195 x 85	1	10000
64	Flete echo-gjinekologjike	copë	A 4	1	2000
65	Flete echo-obstetrike	copë	A 4	1	2000
66	Flete dalje nga spitali	copë	A 4	1	10000
67	Flete percjellese per ekzaminime histo-patologjike	copë	A 4	1	1500
68	Rekomandim i brendshem	copë	A 4	1	10000
69	Flete drejtimi per kemp	copë	A 4	1	1000
70	Flete recete e thjeshte(blok me 100 flete)	copë	140 x 95	1	2000
71	Flete kosto e shpenzimeve	copë	A 4	1	2000
72	Flete analize biokimike	copë	210x150	1	15000
73	Flete percjellese per invalidet	copë	250x175	1	2000
74	Flete shtojce karteles	copë	A4	2	3000
75	Flete autorizimi	copë	210x250	1	1000
76	Flete Echo Abdominale	copë	A4	1	2000
77	Flete raportimi ditor	copë	A4	1	10
78	Efekte te padeshiruara te dhurimit	copë	A4	1	10
79	Rezultatet e laboratorit te sherbimit te transfuzionit	copë	A4	1	10
80	Pyetesor per dhuruesit e gjakut	copë	A4	2	200
81	Aprovimi i pacientit per transfuzionin e gjakut	copë	A4	1	10
82	Instrumentat e monitorimit	copë	A4	1	1000
83	Regjister I planifikimit te edukimit ne vazhdim	copë	A4	100	1
84	Flete vezhgimi i semundjes(Kirurgji)	copë	A4	1	500
85	Regjister i planit te prodhimit	copë	A4	100	2
86	Regjister i shperndarjes se ushqimit	copë	A4	100	2
87	Regjister mjekimi Kardiologji	copë	A4	200	2
88	Pyetesor per pacientin	copë	A4	3	100
89	Flete ditore ushqimi Spital	copë	A4		4000
90	Flete ditore ushqimi Maternitet	copë	A4		1000
91	Certifikate Edukimi(me ngjyre)	copë	A4		350

Afatet e lëvrimit:

Grafiku i levrimit do te percaktohet ne kontrate sipas kerkesave te insrtucionit

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I

KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		



Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 13

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:


1. _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____



Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Dokumentat Standarde të Tenderit

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Dokumentat Standarde të Tenderit

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitësit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Nëse është e parashikuar në kontratë, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e lëvuara një sasi pjesësh këmbimi, në përputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozite përkatëse të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetëgjatësinë e përdorimit të Mallrave.

- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një kohe të arsyeshme/mjaftueshme për t'i lënë mundësi atij që të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japë pa pagesë Autoritetit Kontraktor, nëse ai e kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirëmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, nëse mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
- 12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të pranojë të ndryshojë grafikun e lëvrimit.
- 12.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 12.5 Ekzekutimi i testeve, apo inspektimi i Mallrave nuk e shkarkojnë Kontraktuesin nga garancitë apo detyrimet e tjera sipas kontratës.

Neni 13: Kushtet e Dorëzimit

- 13.1 Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit përveçse kur Kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës. Nëse një Incoterm përdoret për të përshkruar detyrimet e palëve, termi do të ketë kuptimin që i ka dhënë botimi i fundit i *Incotermave*

botuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

- 13.2 Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë sipas specifikimit të kontratës.
- 13.3 Koha e dorëzimit të Mallrave dhe data e përfundimit të Shërbimeve të lidhura me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë.
- 13.4 Dorëzimi i Mallrave duhet të bëhet gjatë orarit të punës me përjashtim të rastit kur kjo kërkesë bie ndesh me ndonjë dispozitë të kontratës.
- 13.5 Kontraktuesi është i detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktor brenda një periudhe kohore të arsyeshme për dorëzimin e Mallrave përpara arritjes së tyre.

Neni 14 Transportimi i Mallrave

- 14.1 Kontraktuesi është i detyruar të sigurojë ngarkimin dhe transportimin e Mallrave siç kërkohet, me qëllim që të plotësojë afatet dhe kushtet e dorëzimit të specifikuar në kontratë.
